



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR

RREGULLORE

Nr. 7 datë 07.09.2018

PËR INVESTIGIMIN DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE

Kjo rregullore është hartuar në bazë Statutit të IKM kapitulli IV, nenet 41-45 si dhe Ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar” i ndryshuar me ligjin nr.10297 datë 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", me ligjin 47/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, si dhe të rregullores Nr. 4 datë 29.03.2018 “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore” të emetuar nga BMP.

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i kësaj rregulloreje

1. Kjo rregullore ka për qëllim :
 - a) zbatimin e kërkesave të statutit dhe të ligjit për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e Keshillit të Drejtimit të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar.
 - b) të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e anëtarëve të institutit, në këtë proces.
 - c) të përcaktojë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore nga Keshilli i Drejtimit të IKM dhe parimet e përgjithshme për funksionimin e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës së një Kontabilisti të Miratuar dhe të shoqërive (firmave) të kontabilitetit vendase dhe të huaja, anëtare të IKM.
2. Kjo rregullore parashikon dispozitat që rregullojnë shqyrtimin e ankimeve ndaj KM dhe shoqërive që zhvillojnë aktivitetin si KM, vendosjen e masave disiplinore ndaj Kontabilistëve të Miratuar dhe zbatimin e tyre nga ana e IKM/Keshilli i Drejtimit në përputhje me kërkesat e statutit dhe legjislationin shqiptar.
3. Kjo rregullore gjithashtu parashikon dispozitat që rregullojnë :
 - a) marrjen e masave disiplinore ndaj të gjitha subjekteve/anëtarëve të cilat janë subjekt i drejtpërdrejt ose indirekt i mbikëqyrjes së IKM-së.

